



BULETIN INFORMATIV

Takim për prezantimin e rezultateve të pilotimit në DVP Elbasan

Aktivitetet e muajit Shkurt 2021



Më 26 shkurt 2021, në mjediset e DVP Pilot të Elbasanit u mbajt një takim me pjesëmarrjen e Z. Gjovalin Loka, Drejtor i Departamentit të Sigurisë Publike në DPPSH, përfaqësues të Programit Suedez (SCPA), Z. Ansi Shundi, Z. Ulrich Dugas dhe Z. Enri Hide, si dhe Drejtori i DVP Elbasan Z. Alket Shatro, Zv. Drejtori për Rendin Publik Z. Nikollaq Palla, Shefi i Komisarariatit të Elbasanit Z. Ermal Lila, si dhe përfaqësues të strukturave të tjera të DVP-së.

Z. Palla paraqiti raportin final të procesit të menaxhimit të ndryshimeve në nivel DVP, duke shpjeguar të gjitha ndryshimet që lidhen me natyrën e punës dhe detyrat e NSPK-ve dhe OPP-ve. Ai shpjegoi zbatimin e këtyre ndryshimeve në nivelin e DVP-së si dhe u ndal në ndryshimet që kanë ndodhur sipas komisariateve. Ai u përqendrua veçanërisht në identifikimin e sukseseve, sfidave dhe mënyrës së kapërcimit të tyre, pasuar nga një sërë rekomandimesh për fazën e konsolidimit të ndryshimeve për DVP-në e Elbasanit.. Sipas tij kjo do të bëhet e mundur veç të tjerave edhe nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës dhe mbështetjes logjistike të NSPK-ve në zonat rurale, ku një rol

të rëndësishëm ka luajtur edhe Programi Suedez e Policimit në Komunitet, përmes mbështetjes me infrastrukturë, logjistike dhe pajisje kompjuterike. Z. Palla solli gjithashtu në vëmendjen e pjesëmarrësve faktin se tashmë OPP-të e DVP Elbasan po marrin gjithnjë e më tepër përgjegjësi si dhe rritjen e bashkëpunimit e koordinimit mes strukturave të policisë në Zonat Policore.


Z. Loka theksoi rëndësinë e ndryshimeve të tilla dhe të konsolidimit të filozofisë së Policimit në Komunitet për të gjithë strukturat e policisë. Ai i nixti përfaqësuesit e DVP Pilot të Elbasanit të angazhohen fuqimisht me konsolidimin e këtyre ndryshimeve në të ardhmen, ndërsa vuri në pah edhe rëndësinë e mbështetjes së Programit Suedez të Policimit në Komunitet në gjithë këtë proces. Z. Loka u shpreh se është shumë e rëndësishme tashmë të ndahen dhe implementohen këto eksperiencia të suksesshme në Elbasan edhe me DVP-të e tjera në shkallë vendi.

Ne fund u konkludua që praktika e deritanishme ka prodhuar rezultate për DVP Elbasan dhe duhet të vijohet me konsolidimin e tyre me gjerë.

AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Takim për prezantimin e rezultateve të pilotimit në DVP Elbasan
- ◆ Takime online me punonjësit e policisë të caktuar për zhvillimin e temave të ndërgjegjësimit në shkolla
- ◆ Zgjerimi i Marreveshjes mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrise së Arsimit.
- ◆ Shpallet thirrja Nr. 5 për Aplikime në Skemën e Granteve për qarqet Kukës, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë.

Takime online me punonjësit e policisë të caktuar për zhvillimin e temave të ndërgjegjësimit në shkolla.



Nga datat 03, 04, 05 Shkurt 2021, SCPA, në bashkëpunim me Sektorin e Policimit në Komunitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, organizoi takime me 29 punonjësit e policisë të 12 DVP-ve të caktuar për të zhvilluar temat e ndërgjegjësimit në shkolla sipas moduleve të aprovuara praktikisht nga DPPSH, MARS dhe programi SCPA.

Takimet u zhvilluan virtualisht në 3 grupe nëpërmjet platformës Zoom.

Agjenda e takimeve u fokusua në çështjet e mëposhtme:

- Përditësim i situatës në lidhje me personelin i cili është caktuar për të realizuar temat e ndërgjegjësimit në komisaritetet përkatëse (problematikat nëse ka).
- Përditësim i situatës logjistike. Gjendja e shpërndarjes së pajisjeve. Identifikimi i punonjësve që s'kanë marrë akoma pajisjet në përdorim?
- A ka filluar zhvillimi i temave ndërgjegjësuese në shkolla ?. Cilat janë arsyet e vonësive?

- Identifikimi i punonjësve të policisë të caktuar për temat e ndërgjegjësimit që nuk janë trajnuar dhe certifikuar akoma.
- Si paraqitet bashkëpunimi me DRAP dhe oficerët e sigurisë në shkolla?.

Gjithashtu, takimet synonin të aktivizojnë një metode alternative të takimeve (të cilat para periudhës së pandemisë kanë qenë periodike) me fokus kryesor lehtësimin e një pjese të konsiderueshme të proceseve të tyre të punës si: komunikimi, zhvillimi i temave të ndërgjegjësimit në ambiente online dhe elementë të tjerë sipas axhendave përkatëse.

Pavarësisht vështirësive teknike, takimet u realizuan në kohë dhe shumica e pjesëtarëve të ftuar arritën të merrnin pjesë në takim.

Në takim u parashtruan problemet, dhe u identifikuan komisaritetet që nuk e kanë filluar ende zhvillimin e temave, për të cilat u dhanë këshilla për të filluar temat në rakordim me zyrat vendore arsimore.

Zgjerimi i Marrëveshjes mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit



Në kuadër të rritjes së aktiviteteve ndërgjegjësuese në shkolla për tema të ndryshme që lidhen me sigurinë, MB dhe Ministria e Arsimit do të zgjerojnë marrëveshjen ekzistuese.

Për këtë, gjatë muajit shkurt janë zhvilluar takime dhe komunikim mes MB, PSh dhe MASR.

Kjo marrëveshje është mbështetur edhe nga Programi suedez.

Me anë të saj Policia e Shtetit dhe Ministria e Arsimit do të shtrijnë fushatat e ndërgjegjësimit për më shumë tema mbi sigurinë në klasat e 10 dhe në shkollat e mesme.

Për zbatimin e kësaj marrëveshje, Programi suedez do të asistojë punonjësit e policisë që merren me edukimin dhe oficerët e sigurisë së shkollave të mesme me materialet për temat dhe me trajnime për rritjen e kapaciteteve të tyre.

Aktivite të tjera

Programi Suedez “Forcimi i Policimit ne Komunitet”, ju njofton se shpall

Thirrjen Nr. 5 për Aplikime në Skemën e Granteve për qarqet Kukës, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë.

Programi do të ofrojë dy lloj grantesh:

Grante deri në 10,000 €

Këto grante do të jepen për projekt-propozime që synojnë

a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të koalicioneve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm mes Policisë së Shtetit dhe komuniteteve vendore si dhe rritjen e besimit të ndërsjellët dhe;

b) Përmirësimin e ndërveprimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, anëtarë të mekanizmave lokale të referimit, për rritjen e cilësisë së masave parandaluese dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Afati kohor për zbatimin e projektit: deri në 12 muaj.

Grante deri në 5,000 €

Këto grante do të mbështesin projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe

komuniteteve duke pasur në fokus rininë, si iniciativa në fushën e zgjidhjes së konflikteve, ndërgjegjësimin, pasojat e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun rrugor, bulizmin dhe krimin kibernetik, trafikimin e qenieve njerëzore, krimet homofobike, ekstremizmin e dhunshëm, etj; me theks të veçantë në masat parandaluese. Afati kohor: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formularit të Aplikimit dhe Udhëzuesit për Aplikime. Të dy këto dokumente mund të konsultohen / shkarkohen nga linku <http://www.cp-project.al/skema-e-granteve/>.

Aplikimi dhe dokumentet mbështetëse (lista e të cilave gjendet tek Udhëzuesi për Aplikime, 5.2.5 Kriteret e Vlerësimit) duhen dorëzuar deri në datën 15 Mars 2021, ora 17:00.

Për një shtrirje sa më të gjere të përfitimit prej këtyre granteve jeni te lutur të shpërndani këtë informacion në rrjetet tuaja.

Për më shume informacion rreth Skemës së Granteve dhe mënyrës se aplikimit, drejtohuni në faqen e internetit të programit www.cp-project.al.